

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa kryetare e kolegjit, Valdete Daka dhe Salih Toplica anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurve L. S., L. B., A. R. dhe Sh. C., për shkak të veprës penale vjedhje grabitqare në bashkëkryerje nga neni 328 par.4 lidhur me par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit Sh. C. paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PPRKR.nr.116/2015 të datës 06.01.2016 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.121/2016 të datës 25.01.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 04.02.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit Sh. C., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda PPRKR.nr.116/15 të datës 06.01.2016 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.121/2016 të datës 25.01.2016.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PPRKR.nr.116/15 të datës 06.01.2016, të pandehurit Sh. C., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale vjedhje grabitqare në bashkëkryerje nga neni 328 par.4 lidhur me par.3 lidhur me par.1 të KPK-së, ia ka vazhduar masën e paraburgimit për 2 (dy) muaj e cila do të

llogaritet nga data 06.01.2016 deri më 06.03.2016. Masa e paraburgimit është caktuar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar. 1.2 pikat 1.2.2, dhe 1.2.3 të KPPK-së.

Në procedurën ankimore, gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN.1.nr.121/2016 të datës 25.01.2016, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

*Paraqitësi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e tij.*

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit Sh. C. av. A. A., për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të anulojë aktvendimin e shkallës së dytë, ndërsa ta ndryshoj aktvendimin e shkallës së parë ashtu që ta ndërpres paraburgimin ose të caktojë ndonjë nga masat më të buta për sigurimin e pranisë së të pandehurit.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit Sh. C. kryesisht thekson se si gjykata e shkallës së parë ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë, me rastin e vazhdimit të paraburgimit në vendimet e tyre nuk kanë dhënë arsye të qarta dhe të pranueshme dhe vetëm kanë parafrazuar dispozitat ligjore si dhe të njëjtin vendim e kanë mbështetur vetëm në supozime. Sipas mbrojtësit prokurori i shtetit në kërkesën për vazhdimin e paraburgimit nuk ka arritur të vërtetojë dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale, ta bëjë përshkrimin e provave, e vetë fakti se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë është bazuar në një kërkesë të tillë i njëjti është kundërligjor dhe i pabazuar.

*Opinionit i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.*

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.6/16 të datës 03.02.2016, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit Sh. C. të refuzohet si e pabazuar.

## *Gjetjet e Gjykatës Supreme*

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike nga shkresat e lëndës kryesisht nga kallëzimi penal, fotodokumentacioni, raportet e zyrtarëve të policisë, procesverbali mbi shikimin e vendit të ngjarjes, deklaratat e të pandehurve tjerë, si dhe provat tjera të mbledhura gjerë më tani rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehurit Sh. C. është kryerës i veprës penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nën par.1.1 të KPPK-së për caktimin e paraburgimit, sepse i njëjti së bashku me të pandehurit tjerë ka bërë marrëveshje paraprake për kryerjen e vjedhjes së kasafortës në kafeterin “.....” në të cilën i pandehuri Sh. C. ka punuar aty si kamarier, i cili edhe i ka informuar të pandehurit tjerë rreth vendndodhjes së kasafortës, shumën e parave që mund të gjinden aty, vendin e derës emergjente nga do të hynin, si dhe duke u siguruar se askush nuk ka mbetur në lokal, e këtë duke e organizuar kinse e ka harruar kuletën me qëllim që menagjeri pas përfundimit të punës i njëjti të ia sjell.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.2 të KPPK-së, sepse po të gjendej i pandehuri në liri ekziston rreziku i asgjësimit, fshehjes apo ndryshimit të provave të veprës penale, ndikimi në të pandehurit tjerë me qëllim të favorizimit të ndonjërit në procedurën penale, duke pas parasysh se hetimet ende nuk kanë përfunduar dhe se nuk është përfunduar ende raporti i autopsisë për të ndjerin N. R., si dhe ende nuk është siguruar raporti lidhur me kërkesën për antenat për vend ndodhjen e të pandehurit tjetër A. R. gjatë periudhës kur dyshohet se është kryer vepra penale.

Gjithashtu kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së, duke pasur parasysh peshën e veprës penale, mënyrën e kryerjes së veprës penale, rrethanat dhe ambientin në të cilën është kryer vepra penale, se i pandehuri me marrëveshje dhe përgatitje paraprake, në bashkëveprim me

të pandehurit tjerë, me qëllim që vetit t'i sjellin dobi pasurore në mënyrë të kundërligjshme, së bashku kanë planifikuar kryerjen e vjedhjes së kasafortës dhe të hollave që gjendeshin në të, e në veçanti mënyra shumë e vrazhdë e kryerjes së veprës penale e cila ka përfunduar me fatalitet me vdekjen e rojës së objektit, lë të besohet se me lëshuarjen e të njëjtit në liri mund të vijë deri te kryerja e veprës penale të natyrës së njejtë apo veprës tjetër penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.32/2016 datë 04.02.2016.

Procesmbajtësja,  
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,  
Emine Mustafa